



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. 1214/1 Prot.

Vlorë më, 28. 04.2026

VENDIM

Nr. 15, datë 28 / 04 /2026

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKT-PROPOZIMEVE TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT,
NË KUADËR TË PROGRAMIT TË KËRKIM-ZHVILLIMIT (PKZHUV),
TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORE, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 93, 95, pika 1, 2, 3, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, pika 3, dhe kreut IX të Statutit të UV-së; nenit 8, pika 6, 7 dhe 8, të Rregullores për Projektet të Kërkim-Zhvillimit të financuara nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; vendimit të Senatit Akademik të UV-së nr. 16, datë 06.05.2021, si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, me nr. 1088/1 prot., datë 20.04.2026 dhe shkresës nr.1088/2, datw 28.04.2026, Rektorati, në mbledhjen e datës 28.04.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë projekt-propozimet me financim nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (PKZHUV), të paraqitur nga Fakulteti i Shëndetit, si më poshtë:
 - E-shëndeti dhe Vlerësimi I Njohurive të Studentëve dhe Stafit akademik: Rekomandime për përditësimin e kurrikulave Infermierore (Ehealth-nc)
 - Ndikimi I trajtimeve estetike dermatologjike në cilësinë e jetës dhe perceptimin e imazhit trupor te femrat: Një studim bazuar në treguesit PRO (Patient Reported Outcomes)
 - Ndikimi I rrezatimit elektromagnetik të radiofrekuencës (RF-EMR) nga telefonat celularë në shëndetin e të rinjve: implikime për edukimin shëndetësor në komunitetin universitar
 - Edukimi ushqimor si strategji për përmirësimin e niveleve të hekurit tek studentët: Një qasje praktike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

- Krijimi I një aplikacioni për mbështetjen në ndërprerjen e duhanit tek studentët
 - Impakti psikosocial i kancerit të gjirit te gratë shqiptare: prevalence, faktorët parashikues dhe nevojat për shërbime të shëndetit mendor lidhur me depresionin
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Ndhmës Akademike në UV.
 3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Fakultetit të Shëndetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Aurela Saliaj

